



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR SARANDË

Adresa: Sarandë, Lagjia nr.1, Rruga: "Onhezmi", Godina nr.69, www.website: www, email: ergi.hado@gjykata.gov.al

Nr. 521 Prot

Sarandë më 19.07.2018

Lënda : Kthim përgjigje në lidhje me kërkesën tuaj me nr.149/18 datë 05.06.2018 .

Qendra "Res Publica" Tiranë .

Drejtimi: Qendra "Res Publica" Tiranë .

I nderuar Z.MATLIJA

Ju urojmë punë të mbarë !

Në lidhje me kërkesën datë 08.06.2018, me objekt "*Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion e dokumentacioni*" po ju sqaroj se, për një pakujdesi të punonjësve të caktuar nga ana e ime si drejtues i gjykatës, ka ngelur pa ju dërguar informacioni i kërkuar, dhe me marrjen e informacionit nga Komisioneri Për të Drejtën e Informimit po ju dërgojmë informacionin e kërkuar nga ana e juaj si më poshtë:

Për vitin 2016

Nr. i avokatëve të caktuar kryesisht të cilët kanë përfituar pagesë nga fondet buxhetore është 11 (njëmbëdhjetë) avokat .

Buxheti për pagimin e avokatëve të caktuar kryesisht nga gjykata është :

Nga fondet buxhetore = 904 000 lekë

Nga të ardhurat e institucionit = 129 000 lekë

Totali = 1 033 000 lekë

Fatura të papaguara në datë 31.12.2016 = 75 000 lekë

Për vitin 2017

Nr. i avokatëve të caktuar kryesisht të cilët kanë përfituar pagesë nga fondet buxhetore është 12 (dymbëdhjetë) avokat .

Buxheti për pagimin e avokatëve të caktuar kryesisht nga gjykata është :

Nga fondet buxhetore = 1 014 000 lekë

Nga të ardhurat e institucionit = 18 000 lekë

Totali = 1 032 000 lekë

Fatura të papaguara në datë 31.12.2017 = 48 000 Lekë

Në të dy vitet nuk ka patur mungesë fondesh për pagesën e detyrimeve për avokatët e caktuar kryesisht. Në muajin Dhjetor të të dy viteve kanë ngelur pa u likuiduar fatura të mbyllura në datë 31 dhjetor për të cilat nuk mund të kryheshin veprime nga Dega Thesarit.

Në lidhje me numrin e saktë të avokateve të caktuar kryesisht nga gjykata për vitin 2016-2017, nuk mund të japim një përgjigje të saktë, për faktin se jo të gjitha dosjet janë të arkivuara pranë gjykatës sonë, pasi janë dhe me ankime në gjykatat më të larta. Por numri i avokatëve që u është bërë pagesa dhe janë paraqitur pranë zyrës së buxhetit të gjykatës është ai i pasqyruar më lartë, dhe nuk ka ankesa nga avokatët në lidhje me mos dhënien e pagesës.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

KRYETARI

Alltun ÇELA